

UDHËZIM
Nr. 17, datë 1.8.2014

PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË 2014, SESIONI I DYTË

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26, 27 dhe 50, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 352, datë 3.4.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektorit Shtetëror të Arsimit”,

UDHËZOJ:

1. Zhvillimin e Provimeve Kombëtare të Arsimit bazë 2014, sesioni i dytë, në datat si më poshtë vijon:
 - a) Gjuha shqipe
27.8.2014;
 - b) Matematika
30.8.2014.
 2. Nxënësit e pakicave kombëtare (greke dhe maqedonase) të zhvillojnë provimin në lëndën “Gjuha amtare”, sesioni i dytë, në datën 25.8.2014.
 3. Për provimet kombëtare të arsimit bazë 2014, sesioni i dytë, të ndiqen procedurat e përcaktuara në rregulloren nr. 2481, datë 9.4.2014, “Për procesin e organizimit dhe zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë (Provime të Lirimit) 2014”.
 4. Provimet Kombëtare të Arsimit bazë 2014, sesioni i dytë, të fillojnë në orën 10:00 dhe të zgjasin 2 orë e 30 minuta.
 5. Hartimi i testeve të kryhet sipas rregullores nr. 2481, datë 9.4.2014, “Për procesin e organizimit dhe zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë (Provime të Lirimit) 2014”.
 6. Për shkollat e pakicës kombëtare greke, testi për provimin në lëndën “Gjuhë anëtare”, sesioni i dytë, të përgatitet nga DAR Gjirokastrë. Zyra Arsimore Delvinë dhe Zyra Arsimore Sarandë tërheqin në DAR Gjirokastrë testin, ditën e provimit.
 7. Për shkollat e pakicës kombëtare maqedonase, testi për provimin në lëndën “Gjuhë amtare”, sesioni i dytë, të përgatitet nga DAR Korçë dhe tërhiqet ditën e provimit nga drejtori i shkollës, shoqëruar nga përfaqësuesi i DAR-së Korçë.
 8. Inspektorati Shtetëror i Arsimit të monitorojë procesin e Provimeve Kombëtare të arsimit bazë 2014, sesioni i dytë.
 9. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi zëvendës-ministri i Arsimit dhe Sportit, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e provimeve, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arimore.
- Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla